



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 692/1 Prot.

Tiranë, më 10. 05. 2019

V E N D I M

Nr. 59, Datë 10. 05. 2019

Mbështetur në nenin 32/1/a të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi është paraqitur ankesa Nr. 187 rregj., datë 11.12.2018, e R. H. kundër subjektit “Sweet Bar”, në të cilën pretendohet për diskriminim “*për shkak të racës, ngjyrës dhe etnisë¹*”.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I :

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Subjekti ankues, shprehet se me datë 19.11.2018, rreth orës 14:00-15:00, së bashku me dy shokë të tij të komunitetit rom (sipas tij të tre dallojnë dukshëm që i përkasin këtij komuniteti nga ngjyra e lëkurës), është ulur për të konsumuar diçka në kolltukun përballë banakut të “Sweet” Bar Tiranë, në Rrugën e Dibrës. Pasi kanë pritur për rreth 12 minuta për të dhënë porosinë, kamarieri i lokalit (sipas ankuesit një djalë rreth të 20-ave), i është afruar duke i thënë se: “*Nuk mund t’iu shërbejmë pasi lokali është vetëm për familjar*”. Ndërkohë ankuesi i është drejtuar kamarierit duke e pyetur për dy tavolina e tjera, në një prej të cilave ishin ulur tre vajza dhe në tjetrën dy burra (një prej të cilëve me uniformë policie). Në përgjigje të ankuesit, kamarieri ka sqaruar ankuesin se: “*Ata janë klientë të përhershëm dhe ju lejohet, sepse lokali është për familjar*”.

Sipas ankuesit, tavolina apo lokali nuk kishte të ekspozuar ndonjë lajmërim ku të thuhej se lokali është për familjar apo tavolinat të kishin etiketat “*Rezervuar*”.

¹ Ankuesi është vetëdeklaruar si pjesë e komunitetit Rom.

Në përfundim të ankesës, ankuesi pretendon se ky gjest, ka ardhur si rezultat i racës, ngjyrës dhe etnisë, për të cilin kërkojnë nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatimin e diskriminimit, nga ana e punonjësit të “Sweet” Bar Tiranë.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Në nenin 1 të ligjit nr. 10 221/2010, parashikohet objekti i këtij ligji, duke u sanksionuar se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë², gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Neni 7 i LMD-së³, në pikën 1 të tij, parashikon se: “ Çdo veprim apo mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë apo privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë apo grupe personash, përbën diskriminim”.

Bazuar në nenin 32/1/c të ligjit, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkeljet që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me këtë shkak.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32, pika 2 dhe 33, të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

Pas analizimit të ankesës, u konstatua se nga pikëpamja formale, ajo i plotësonte kërkesat e parashikuara nga neni 33, pika 3 të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”. Për këtë arsye, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi filloi procedurat përkatëse për shqyrtimin e saj.

1. Përsa më lart, me anë të shkresës Nr. 1706/1 prot., datë 13.12.2018, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi i është drejtuar subjektit privat Sweet Bar, ku i ka kërkuar informacion dhe parashtrime rreth ankesës së paraqitur nga ana e R. H.

² Referuar Komisionit Evropian kundër racizmit dhe jo tolerancës. ECRI Rekomandimi Nr. 7, CRI(2003)8 “Diskriminim racial është çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preference që bazohet se shkaqe si raca, ngjyra, gjuha, besimi fetar, shtetësia ose origjina etnike ose kombëtare, justifikon përbuzjen për një person ose një grup personash, ose nocionin e superioritetit të një personi ose një grupi personash”.

³ Shkurtesë për ligjin “Për mbrojtjen nga diskriminimi”.

2. Referuar mungesës së përgjigjes nga ana e subjektit Sweet Bar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi vendosi të realizojë një seancë dëgjimore mes palëve. Për këtë me anë të shkresës Nr. 252 prot., datë 14.02.2019, Komisioneri njoftoi palët për zhvillimin e seancës dëgjimore dhe u kërkua nga palët të informacionin lidhur me pretendimet e ngritura nga ana e subjektit ankues.

Sipas njoftimit të realizuar për zhvillimin e seancës dëgjimore, nga ana e palës ankuese dhe palës ndaj së cilës është paraqitur ankesa nuk u paraqit asnjë përfaqësues.

Megjithatë, në përgjigje të shkresës Nr. 252 prot., datë 14.02.2019, ankuesi me anë të shkresës⁴ datë 22.02.2019, sqaroi se për shkak se shkresa e KMD-së ka shkuar me vonesë dhe për arsye shëndetësore të tij nuk e kishte të mundur të ishte pjesë e seancës.

Gjithashtu, nga ana e administratorit të subjektit “Sweet Bar”, z. Elis Tusha, me anë të e-mailit datë 21.02.2019, u sqarua situata e ndodhur më datë 19.11.2018, duke theksuar se: *“Zotëria është paraqitur në lokal dhe është ulur tek zona e kolltuqeve që janë me rezervim në lokal, dhe aty ka qënë i ekspozuar Rezervimi. Kamarieri i ka thënë që ambjenti i kolltuqeve është për personat që kanë kryer një rezervim dhe mund të ulen në pjesën tjetër të lokalit. Në lokalin tonë personat e komunitetit rom janë klientë të përhershëm, gjë që mund të vërtetohet nga postimet në facebook. Pasi shqyrtuam rastin në fjalë, vumë re se një nga miqtë e ankuesit (shtetasi O. Sh.) është klient në barin tonë dhe ska pasur asnjë lloj problematike të tillë”*

3. Në vijim të procedurave hetimore, mbështetur në Urdhrin nr. 73, datë 18.04.2019 të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, *“Për kryerjen e inspektimit pranë Sweet Bar Tiranë, me qëllim marrjen e informacionit, lidhur me ankesën e shtetasit R. H.”*, inspektorët e KMD-së u paraqitën pranë subjektit Sweet Bar, më datë 18.04.2019, për të marrë informacion dhe për të kryer verifikimet përkatëse mbi çështjen në fjalë.

Gjatë inspektimit të kryer, inspektorët e KMD-së morën takim me përfaqësuesin e Sweet Bar, shtetasin K. H. Sipas K. H. në subjektin Sweet Bar, ndodheshin gjithsej rreth 15 komplete me tavolina dhe karrike, si dhe 3 komplete me kolltuqe, e cila është një zonë më e veçuar nga pjesa tjetër e lokalit. Në tavolinat me kolltuqe vazhdimisht është e ekspozuar tabela me mbishkrimin “Rezervuar”, pasi kryesisht gjatë sezonit të dimrit, në pjesën e dytë të ditës përdorëshin me rezervim nga klientët. Zakonisht ky ambjent (me kolltuqe) rezervohej nga familje apo klientë që shoqëroheshin me fëmijë të vegjël. Nga ana e K. H., nuk ka patur ndonjëherë tjetër ankesa të mëparshme të këtij lloji, pasi lokali ndodhet në një zonë të populluar nga anëtarë të komunitetit rom dhe egjiptian dhe një pjesë e tyre janë klientë të përhershëm në lokal.

Në vijim inspektorët e KMD-së, kërkuan të takoheshin me kamarierin e lokalit që ndodhej në shërbim më datë 19.11.2018, ditën kur kishte ndodhur situata. Nga ana e K. H., u sqarua se punonjësi që ka qënë në shërbim ditën që ka ndodhur situata e pretenduar nga ana e R. H., nuk ndodhet pasi është larguar nga puna.

⁴ Protokolluar pranë KMD-së me Nr. 252/1 prot., datë 25.02.2019

Adresa: Rruga “Durrësit”, Nr. 27 (ish Ministria e Mjedisit), Tiranë, Tel: +355 4 2431078, E-mail: info@kmd.al, Web: www.kmd.al

Gjithashtu K. H. shtoi se një nga miqtë e ankuesit që ka qënë edhe më datë 19.11.2018, së bashku me R. H. në lokal, vijon të jetë klient i shpeshtë i Sweet Bar dhe nuk ka ngritur asnjë pretendim lidhur me shërbimin apo sjelljen e stafit ndaj tij. Për asnjë moment ankuesi nuk është fyer apo ofenduar nga ana e stafit të Sweet Bar për shkaqet që ai pretendon, por i është thënë që mund të ulet në pjesën tjetër të lokalit dhe jo të largohet.

Në përfundim të inspektimit, inspektorët e KMD-së konstatuan se zona kun ndodheshin kompletet e kolltuqeve ishte e veçuar nga pjesa tjetër e lokalit dhe në tavolinat e tyre ndodhej një tabelë me mbishkrimin “Rezervuar”. Gjithashtu, në momentin e inspektimit në lokal ndodheshin edhe klientë të cilët i përkisnin komunitetit rom/egjiptian, fakt që na u dha nga ana e K. H.

Gjatë shqyrtimit të kësaj ankese, Komisioneri ka marrë në shqyrtim vetëm ato çështje, që bëjnë pjesë në kompetencat e tij, të parashikuara nga ligji nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”.

III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.

A. Lidhur me trajtimin e pabarabartë ose të pafavorshëm.

Në nenin 1 të ligjit nr. 10 221/2010, parashikohet objekti i këtij ligji, duke u sanksionuar se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.*

Ligji 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, në nenin 3/1, parashikon se: *“Diskriminim” është çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi”.*

Parimi i barazisë para ligjit dhe i mosdiskriminimit, sanksionohet nga Kushtetuta si një parim i përgjithshëm që përkrah të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, prandaj ai duhet të gjejë shprehjen e tij në të gjithë legjisllacionin shqiptar si dhe të zbatohet nga të gjithë, si nga institucionet edhe nga individët.

Pas shqyrtimit të ankesës dhe ndjekjes së procedurës hetimore, Komisioneri vlerëson se, subjekti ndaj të cilit është paraqitur ankesa, është një biznes i cili ndodhet shumë pranë një zone të populluar nga qytetarë të komunitetit rom dhe egjiptian. Ky fakt u konstatua gjatë procedurës

hetimore të kryer nga KMD, por u pohua edhe nga përfaqësuesit e subjektit Sweet Bar. Gjatë procedurës hetimore, u konstatua se Sweet Bar ishte një ambient biznesi që frekuentohej nga klientë të të gjitha komuniteteve.

Në përfundim, Komisioneri vëren se pala ankuese nuk ka vënë në dispozicion të KMD-së, argumenta apo prova dhe fakte me anë të të cilave të vërtetohej situata diskriminuese e pretenduar prej tij. Gjithashtu, zyra e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi në përfundim të hetimeve të kryera, nuk arriti të sigurojë prova dhe fakte, për të vërtetuar situatën e pretenduar nga ana e shtetasit R. H.

Për sa më sipër, në mungesë të informacionit për të vërtetuar situatën diskriminuese të pretenduar dhe në mbështetje të nenit 95, të Ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, në të cilën parashikohet: *Pamundësia në objekt apo qëllim: “Organi publik deklaron të përfunduar procedurën administrative pa një vendim përfundimtar për çështjen, kur objekti për të cilin kishte nisur procedura apo qëllimi i tij është bërë i pamundur”*, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi vendosi pushimin e shqyrtimit të çështjes.

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenin 95, të Ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, nenin 32, pika 1, gërma a) si dhe nenin 33, pika 10 të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Ndërprejjen e procedurave hetimore dhe pushimin e shqyrtimit të çështjes lidhur me ankesën e shtetasit R. H., për shkak të pamundësisë për të siguruar informacionin e nevojshëm për marrjen e një vendimi përfundimtar.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda afateve ligjore.

KOMISIONERI

Robert GAJDA

(Shkaku: Raca, Ngjyra dhe Etnia)
(Fusha: Të mira dhe shërbime)